

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

**Xhezair Zaganjori** - Kryesues  
**Evelina Qirjako** - Anëtar  
**Medi Bici** - Anëtar

në dhomë këshillimi më datë 30.06.2016 mori në shqyrtim çështjen administrative nr. 02001/2015, që u përket palëve:

**Paditës:** Agron Spaho

**I Paditur:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

**Objekti:** Shfuqizimin tërësor të aktit administrativ Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 5104/5, datë 25.02.2014 “vendim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” këtu e si vijon do të referohet “vendimi”; Konstatimin paligjshmërisë së veprimit administrativ që nuk prodhon pasoja juridike dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës; Detyrimin e organit publik të rikthejë në detyrën e mëparshme paditësin në zbatim të nenit 146/3 dhe 155/3 për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme; Detyrimin e organit publik të paguaj për paditësin në zbatim të nenit 144/5 të KPunës 2 paga për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës; Detyrimin e organit publik të paguaj paditësin në zbatim të nenit 145/2 dhe 152 të KPunës shpërblim për vjetërsi të llogaritur për 7 vite të plota në total 3.55 paga mujore; Detyrimin e organit publik të paguaj për paditësin në zbatim të nenit 146/3 dhe nenit 155/3 të KPunës një vit pagë.; Detyrimin e të paditurit të trajtojë me pagë paditësin deri në përfundimin e gjyqimit me vendim të formës së prerë në zbatim të nenit 155 të KPunës duke përfshirë minimalisht detyrimin prej 3 pagash për mosrespektim të aftit ë njoftimit.

**Baza Ligjore:** Nenet 7, 11,15,17 e vijues të ligjit nr. 49/2012; nenet 154, 156, të KPrC, VKM 205, datë 13.04.1999 i ndryshuar nenet 143,144, 145, 146, 151, 152, 155 të KPunës.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Tiranë me vendimin nr. 3722, datë 01.07.2014 ka vendosur: Pranimin e pjesshëm të padisë.** Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që t'i paguajë paditësit dëmshpërblim pagën e 12 muajve për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që t'i paguajë paditësit pagën e 3 muajve për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që t'i paguajë paditësit dëmshpërblim pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që t'i paguajë paditësit pagën e 3 muajve dhe 15 ditë punë si shpërblim për vjetërsinë në punë. Rrëzimin e kërkimit shfuqizimin tërësor të aktit administrativ vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr. 5104/5, datë 25.02.2014 “Vendim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” si të pabazuar në ligj.

**Gjykata e Administrative e Apelit me vendimin nr. 1289 datë 04.06.2015 ka vendosur : Lënien në fuqi të vendimit nr. 3722, datë 01.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .**

**Kundër vendimit nr. 1289 datë 04.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit** ka paraqitur rekurs pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 3722, datë 01.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr. 1289 datë 04.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rrëzimin e plotë të padisë

### V E N D O S I

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1289 datë 04.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit përsa i përket dëmshpërblimit për zgjidhjen e kontratës së punës, të afatit të njoftimit, shpërblimit për vjetërsi, si dhe pjesës së rrëzimit të padisë. 2. Ndryshimin e Vendimit nr. 3722, datë 01.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Vendimit nr. 1289 datë 04.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit përsa i përket dëmshpërblimit për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punë dhe rrëzimin e padisë për këtë pjesë.

Tiranë, më 30.06.2016